

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ Kronos Kapital “ shpk**

Në Tiranë, sot më datë 24.01.2022, ne të poshtëshënuarit:

- 1- Emiland Skora, i datëlindjes 25.09.1980, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: karte identiteti, me numër personal I00925040E,
- 2- Matthew Thomas Reid, i datëlindjes 29.01.1980, lindur në USA dhe banues në USA, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër 566954207.

me cilësinë e “ortakëve themelues” deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “**Kronos Kapital” shpk**,

*Neni 1*

*Emri, Forma*

Shoqëria do të ketë emrin “**Kronos Kapital**”, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

*Neni 2*

*Personaliteti juridik*

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

---

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka seline në adresë: Bashkia Delvine, Fshati Vanë, Zone Kadastrale 3710, Numer pasurie 15.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Prodhim, shitje, tregetim, energji elektrike. Çdo operacion ekonomik te lejuar nga legjislacioni shqiptar.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 1.000.000 (nje milion) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota, i cili zotërohet si më poshtë:

Emiland Skora, zotëron 1 kuotë me vlerë 300.000 (treqindmije) lekë, e cila përbën 30 % të kapitalit të shoqërisë.

Matthew Thomas Reid, zotëron 1 kuotë me vlerë 700.000 (shtateqindmije) lekë, e cila përbën 70% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

#### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme vetëm me rrugë trashëgimie. Transferimi i kuotave si ortakëve të shoqërisë ashtu edhe për personat e tjerë jashtë shoqërisë është i kushtëzuar me miratimin e Asamblesë.

#### Neni 8

#### Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;  
b) ndryshimet e statutit;  
c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;  
ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;  
d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;  
ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;  
f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;  
g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;  
gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;  
h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;  
i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 9

#### Administrimi

Administratorë të shoqërisë janë:

- Emiland Skora, i datëlindjes 25.09.1980, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: karte identiteti, me numër personal I00925040E, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërritje.

#### Neni 10

#### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare "**Kronos Kapital**" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKËT THEMELUES**

Emiland Skora



Matthew Thomas Reid

